



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE**  
**KESHILLI BASHKIAK**

Nr 476/Prot  
12

Tropojë, me 2.03.2022

**VENDIM**

**Nr 16 , Datë 28. 02. 2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË RISHIKIMIT  
TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA TROPOJË**

Mbështetur në nenin 23, pika 14 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, në nenin 5, pika 1.3, shkronja b, nenin 12, pika 2, shkronja "a", nenin 13, pika 1, shkronja "b" dhe "c", nenin 20, nenin 26, pika 2 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në nenin 11,12 dhe 62 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", e ndryshuar, në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.2, datë 09.12.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Tropojë", në Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tropojë, Nr. 122, datë 15.11.2021 Për Ndërmarrjen e Nismës për Rishikimin e PPV-së", në Udhëzimin e AKPT Nr.1, datë 06.12.2021, "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar", si dhe në Aktin e Përputhshmërisë me Nr. 416 Prot, datë 25.02. 2022, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tropojë, në mbledhjen e datës 28.02.2022, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tropojë me procedurë të thjeshtuar, sipas **Aktit të Përputhshmërisë lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit**, pjesë e të cilit është dokumenti i mëposhtëm:
  - Dokumenti i Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tropojë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Tropojë për mbarëvajtjen e procesit deri në miratimin dhe zbardhjen e PPV-së së rishikuar, sipas detyrimit ligjor.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Tropojë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi për miratimin e dokumentit të Rishikimit të PPV Tropojë botohet në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit nga Bashkia Tropojë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

SEKRETAR  
Ergent GJONGECAJ



KRYETAR  
Shotë BASHAJ



Shpallur me 02.03.2022  
Miratuar me 12 vota  
Vota Pro 12  
Vota Kunder 0  
Vota Abstenim 0